



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

FOL

BIRN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | KOSOVO

PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË MONITORIMI I PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE



**PROGRAMI PËR FUQIZIMIN
E SISTEMIT TË DREJTËSISË
MONITORIMI I PUBLIKIMIT
TË AKTGJYKIMEVE**

Nëntor 2019 – gusht 2020

Titulli: Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë - Monitorimi i publikimit të aktgjykimeve

Autore: Nora Bajrami dhe Albana Hasani

Viti i botimit: Tetor 2020

Dizajni dhe shtypi: Envinion

Publikuar nga:

Lëvizja FOL

“Andrea Gropa” nr.35

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Ky raport është realizuar me përkrahjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe jo domosdo reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	10
METODOLOGJIA.....	11
PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE – BAZA LIGJORE	12
PASQYRË E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE GJATË PERIUDHËS I MAJ – 15 NËNTOR 2019	13
GJETJET NGA MONITORIMI I PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE (I NËNTOR 2019 – 31 GUSHT 2020)	16
Gjykata Supreme	19
Gjykata e Apelit.....	22
Gjykata Themelore e Prishtinës	25
Gjykata Themelore e Prizrenit.....	28
Gjykata Themelore e Ferizajt.....	31
Gjykata Themelore e Mitrovicës	34
Gjykata Themelore e Gjakovës	37
Gjykata Themelore e Gjilanit	40
Gjykata Themelore e Pejës.....	43
REKOMANDIME.....	46
BURIMET	47

Programi i USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP) është një aktivitet pesëvjeçar i sundimit të ligjit në Kosovë si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme të USAID-it për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe të sigurojë që sistemi i drejtësisë operon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi fokusohet në promovimin e sistemit të drejtësisë bazuar në standardet më të larta të pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe në mbështetje të funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në komunat në veri. Fuqizimi i efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e gjyqësorit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore. Përmes USAID-it, Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat në konsolidimin e rezultateve, në efektshmërinë dhe menaxhimin e tyre.

Lëvizja FOL është organizatë joqeveritare e përkushtuar që të kontribuojë për qeverisje të mirë, parandalim dhe luftim të korrupsionit përmes mbështetjes dhe promovimit të qytetarisë aktive, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Përmes hulumtimit të politikave, avokimit dhe mbështetjes teknike institucionale dhe monitorimit të institucioneve publike FOL rrit presionin publik mbi vendimmarrësit për të zvogëluar abuzimin e pushtetit. Përveç forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së organeve vendimmarrëse dhe zyrtarëve publikë, FOL punon për të hapur kanale të reja të komunikimit në mes të Qeverisë dhe qytetarëve për të zvogëluar apatinë qytetare.

BIRN Kosova është organizatë e pavarur joqeveritare, qëllimi kryesor i së cilës është të kontribuojë për një proces të suksesshëm demokratik, përfshirë reformat në sistemin e drejtësisë. Për ta bërë këtë, BIRN krijoi një platformë të njohur online anti-korrupsion, prodhoi dhe transmetoi debate televizive, hetime terreni dhe raporte me ndikim analitik.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lëvizja FOL (FOL) me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP) dhe në partneritet me BIRN Kosova (BIRN), përmes projektit “Kërkimi i transparencës në sistemin gjyqësor të Kosovës” kanë zhvilluar raportin “Monitorimi i publikimit të aktgjykimeve”. Ky raport përmban të dhëna faktike dhe analizë krahasimore që rrjedh nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve në web-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës prej datës 1 nëntor 2019 deri më 31 gusht 2020.

Transparenca në gjyqësorin e Kosovës paraqet një sfidë të vazhdueshme në aspektin e përmbushjes së misionit të ndërtimit të gjykatave të besueshme, si dhe një detyrë të pashmangshme të secilit gjyqtar dhe zyrtari tjetër që të ndihmojë në përmbushjen e këtij misioni. Pa dyshim se synimi i secilit prej tyre konsiston në drejtim të respektimit të parimeve dhe vlerave themelore të një gjyqësie bashkëkohore. Mirëpo, monitorimi i punës së gjykatave, e sidomos i gjyqtarëve, paraqet një domosdoshmëri që siguron një mekanizëm të vlerësimit institucional dhe burim të gjetjes së mangësive që duhet të shmangen.

Ky raport ka për qëllim që të paraqesë gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, të identifikojë problemet dhe sfidat në publikimin e aktgjykimeve, si dhe të ofrojë një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndërmarrin për të përmirësuar shkallën dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve. Publikimi i aktgjykimeve përveç se paraqet përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga ligji dhe rregulloret në fuqi, paraqet edhe një standard institucional që do të duhej të vihej në jetë nga secili organ shtetëror në promovim të transparencës.

Monitorimi i publikimit të aktgjykimeve nga Lëvizja FOL dhe BIRN ka filluar në muajin maj 2019. Gjatë monitorimit janë mbledhur të dhëna mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara si dhe është përcjellë dinamika e publikimit të tyre nga shtatë gjykatat themelore, Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit. Që nga kjo kohë është vërejtur rritje e vazhdueshme në publikimin tyre. Gjatë periudhës nëntor 2019 – gusht 2020, gjykatat e Kosovës kanë publikuar rreth 2,000 aktgjykime për muaj – publikim i cili nuk është vërejtur më parë në gjykatat tona. Ndërkaq gjatë fazës së parë të monitorimit të publikimit të aktgjykimeve (gjatë muajve maj - 15 nëntor 2019), gjykatat e Kosovës kanë publikuar 6,611 aktgjykime (mesatarisht rreth 1,000 aktgjykime në muaj), rritje kjo e shumëfishuar në krahasim me periudhën janar 2016 – prill 2019, kur gjykatat publikonin mesatarisht vetëm rreth 250 aktgjykime për muaj.

Për të pasqyruar edhe më mirë këtë rritje duhet të theksohet se nga 1 janari 2016 deri në muajin prill 2019 në web-faqen e KGJK-së ishin publikuar vetëm 9,061 aktgjykime, apo rreth 225 aktgjykime për muaj. Nga fillimi i monitorimit të web-faqes së KGJK-së në muajin maj 2019 e deri në muajin gusht 2020, gjykatat kanë publikuar 21,630, apo rreth 1,350 aktgjykime për muaj, duke e sjellë kështu numrin total në 30,691 aktgjykime të publikuara në web-faqen e KGJK-së.

Totali i aktgjykimeve për gjykata	2016	2017	2018	Deri më 30 prill 2019	Maj 2019 – gusht 2020
Gjykata Supreme	72	213	265	217	1,319
Gjykata e Apelit	56	266	444	189	2,739
Gjykata Themelore e Prishtinës	72	483	1,088	197	4,565
Gjykata Themelore e Ferizajt	116	599	642	52	2,723
Gjykata Themelore e Prizrenit	73	196	901	226	3,731
Gjykata Themelore e Gjakovës	15	156	464	219	2,056
Gjykata Themelore e Pejës	7	128	161	31	1,250
Gjykata Themelore e Mitrovicës	0	9	511	117	2,194
Gjykata Themelore e Gjilanit	153	413	306	4	1,053
Totali i gjykatave	564	2,463	4,782	1,252	21,630
TOTALI 30,691					

TABELA I: Të dhënat me publikimet e aktgjykimeve nga secila gjykatë për periudhën 1 janar 2016 – 31 gusht 2020.

Duke e marrë parasysh se gjatë periudhës monitoruese, respektivisht në muajin mars 2020, vendi ynë u prek nga pandemia e COVID-19 dhe shumica e institucioneve filluan të punojnë me staf të reduktuar në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti publik, kjo ka ndikuar që puna e institucioneve gjyqësore të përgjysmohet deri në atë masë sa të ndikojë në punën e rregullt të tyre. Rrjedhimisht, për shkak të kësaj situatë, ne kemi vërejtur se edhe gjykatat gjatë muajit prill dhe maj kishin një rënie të shprehur në publikimin e aktgjykimeve. Megjithatë, përshtatja me situatën e krijuar bëri që gjykatat përsëri të vazhdojnë me trendin e lartë të publikimit të aktgjykimeve.

- Gjatë periudhës nëntor 2019 - gusht 2020 në web-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë publikuar gjithsej 15,717 aktgjykime. Tri gjykatat me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit janë: *Gjykata Themelore e Prishtinës* me 4,000 aktgjykime të publikuara; *Gjykata Themelore e Prizrenit* me 2,793 aktgjykime si dhe *Gjykata e Apelit* me 1,631 aktgjykime.
- Degët e gjykatave me më së shumti aktgjykime të publikuara janë: *Dega e Suharekës* me 987 aktgjykime, *dega e Podujevës* me 477 aktgjykime si dhe *dega e Lipjanit* me 391 aktgjykime.
- Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit prijnë me numrin më të madh të aktgjykimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. I pari në renditje qëndron gjyqtari *Luan Berisha*, i cili gjatë kësaj

periudhe ka publikuar 442 aktgjykime. Më pas renditet gjyqtari *Qemajl Suka*, i cili ka publikuar 331 aktgjykime dhe gjyqtari *Robert Tunaj*, me 318 aktgjykime të publikuara.

- Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 59.61% janë aktgjykime të natyrës penale; 33.79% janë aktgjykime të natyrës civile; 5.7% janë administrative dhe vetëm 0.9% janë të natyrës ekonomike.
- Publikimi i aktgjykimeve të korrupsionit vazhdon të jetë ende i ulët, ndërsa është dyfishuar publikimi i aktgjykimeve me bazë në dhunën gjinore dhe aktgjykimet e krimit të organizuar. Gjatë kësaj periudhe janë publikuar vetëm 62 aktgjykime të korrupsionit, 135 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore dhe 50 aktgjykime të lëndëve nga rastet e krimit të organizuar. Gjykata Themelore e Prishtinës ka prirë në këtë fushë duke publikuar numrin më të lartë të këtyre aktgjykimeve në krahasim me gjykatat e tjera.
- Gjatë kësaj faze të monitorimit zbatimi në përpikëri i vendimit të KGJK-së për standardizimin e formave të aktgjykimeve është evidentuar në 12,873 aktgjykime, apo në 81.90% të të gjitha aktgjykimeve të publikuara, zbatim ky dukshëm më i lartë sesa gjatë periudhës së parë të monitorimit, kur vetëm 58% e aktgjykimeve të publikuara ishin në përputhje me këtë vendim.
- Gjatë kësaj periudhe, nga 15,717 aktgjykime të publikuara, 99.58% janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa vetëm 0.42% në gjuhën serbe.
- Prej të gjitha aktgjykimeve të publikuara, 99.57% e aktgjykimeve janë të anonimizuara. Këto shifra tregojnë avancim të madh në fshehjen e të dhënave personale në aktgjykimet e publikuara krahasuar me periudhën 1 maj - 15 nëntor 2019, kur nga 6,611 aktgjykime, 230 prej tyre kanë qenë të paanonimizuara.
- Gjykatave u janë dashur mesatarisht 117 ditë për t'i publikuar aktgjykimet në web-faqen e KGJK-së, mesatare kjo që bie ndesh me kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat, i cili parasheh 60 ditë për t'i publikuar ato, llogaritur nga dita e shpalljes.¹ Gjykatat të cilat në përpikëri e kanë zbatuar këtë afat janë: Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore e Ferizajt dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës. Ndërsa, më së shumti kohë në publikimin e aktgjykimeve u është dashur Gjykatës Themelore të Prizrenit, Gjilanit dhe asaj të Gjakovës.

Ajo që është e rëndësishme të theksohet lidhur me rekomandimet e bëra për fazën e parë është se ato kishin dhënë rezultatet e duhura, duke e ngritur kështu cilësinë e aktgjykimeve të publikuara. Gjatë kësaj kohe, përveç që është shumëfishuar publikimi i aktgjykimeve në përgjithësi, gjithashtu është zvogëluar dukshëm publikimi i tyre pa fshehjen e të dhënave personale. Ndërkaq, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka filluar të publikojë raporte mujore në lidhje me nivelin e publikimit të aktgjykimeve. Më tutje, publikimi i aktgjykimeve në formatin word është reduktuar në masë të madhe, gjë që është tregues i qartë për rritjen e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara² dhe është reduktuar publikimi i aktgjykimeve të dublifikuara. Po ashtu është zvogëluar shprehimisht publikimi i aktgjykimeve me numra identikë të lëndëve. Degës së Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq i është siguruar kyçja në internet. Këto ishin disa nga rekomandimet kryesore të dhëna në raportin e parë të publikimit të aktgjykimeve, e të cilat janë implementuar plotësisht në fazën e dytë.

¹ Ligji (nr. 06/L – 054) për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

² Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, 2019.

HYRJE

Lëvizja FOL (FOL) me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP) dhe në partneritet me BIRN Kosova (BIRN), janë duke e zbatuar projektin "Kërkimi i transparencës në sistemin gjyqësor të Kosovës". Në bashkëpunim të ngushtë me USAID/JSSP, përmes këtij projekti, FOL dhe BIRN synojnë të përmirësojnë efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor.

Raporti "Monitorimi i publikimit të aktgjykimeve" ka për qëllim të paraqesë gjendjen aktuale të publikimit të aktgjykimeve duke pasur parasysh disa elemente bazë, të cilat duhet të jenë në harmoni me ligjet, rregulloret si dhe udhëzimet administrative, të cilat janë në fuqi. Po ashtu, përmes këtij raporti synojmë të forcojmë edhe më tej sistemin gjyqësor për të promovuar edhe më shumë transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e punës së gjykatave përmes publikimit sa më të madh të aktgjykimeve.

Lëvizja FOL ka filluar monitorimin e publikimit të aktgjykimeve në web-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që nga muaji maj 2019. Faza e parë e monitorimit dhe raportimit të publikimit të aktgjykimeve përfshinte muajt maj - 15 nëntor 2019, ndërkaq faza e dytë e monitorimit dhe raportimit përfshin gjetjet nga periudha nëntor 2019 – gusht 2020.

Ky raport i monitorimit mund t'i shërbejë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore dhe të gjitha organeve të tjera brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, sepse ofron një pasqyrë të qartë të publikimit të aktgjykimeve në lidhje me atë se sa po respektohet Ligji për Gjykatat, Udhëzimi Administrativ për Anonimizimin e Aktgjykimeve dhe Vendimi për Standardizimin e Aktgjykimeve, në çfarë gjuhe publikohen, sa publikohen lëndë të natyrës së korrupsionit, të dhunës me bazë gjinore dhe të krimit të organizuar, cili nga gjyqtarët është më aktiv në publikimin e tyre, etj.

METODOLOGJIA

Lëvizja FOL ka përdorur metodën e monitorimit të vazhdueshëm, pra monitorimin ditor të web-portalit të KGJK-së. Paraprakisht, të gjitha gjykatat janë informuar përmes postës elektronike se ato do jenë subjekt i monitorimit për numrin dhe dinamikën e publikimit të aktgjykimeve, si dhe nëse publikimi i aktgjykimeve ndjek kërkesat e veçanta të ligjit, udhëzimit dhe vendimeve relevante. Të dhënat e mbledhura nga procesi i monitorimit janë paraqitur në formë info-grafikash, të cilat janë shoqëruar me artikuj të shkurtër, janë publikuar çdo muaj në faqen e internetit dhe mediave sociale të Lëvizjes FOL³, si dhe në platformën Kallxo.com.⁴

Lëvizja FOL fillimisht ka mbledhur të dhëna për numrin e aktgjykimeve të publikuara nga të gjitha gjykatat, duke përfshirë edhe degët e tyre. Faza e mbledhjes së të dhënave është ndarë në dy pjesë: (1) Aktgjykimet e publikuara me Ligjin e vjetër për Gjykata 1 janar 2016 – 31 dhjetor 2018, dhe (2) Aktgjykimet e publikuara me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatat 1 janar 2019 – 30 prill 2019.⁵

Nga aktgjykimet e publikuara Lëvizja FOL ka krijuar një databazë, e cila ndër të tjera, përmban:

- Numrin e aktgjykimeve të publikuara nga çdo gjykatë për çdo muaj;
- Respektimi i protokolleve dhe afateve të përcaktuara për publikimin e vendimeve si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe Udhëzimet Administrative;
- Mbrojtja e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe akte tjera.
- Pasqyrimi i numrit total të të gjitha aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, si dhe gjykatat themelore të Kosovës, duke mos përjashtuar degët e tyre;
- Pasqyrimi i numrit total të aktgjykimeve të publikuara sipas gjyqtarëve;
- Nivelin e zbatimit të Shabllonit Standard të Aktgjykimeve.
- Gjuha në të cilën janë publikuar aktgjykimet, si dhe
- Llojin e lëndëve për të cilat ka më shumë aktgjykime të publikuara.

Për të identifikuar dhe ndihmuar në adresimin e mangësive në procesin e publikimit në web-portalin e KGJK-së, Lëvizja FOL, ndër të tjera, ka zhvilluar vizita në gjykata, si dhe intervista me stafin e ngarkuar nga ana e gjykatave për publikim të aktgjykimeve.

³ Artikulli i publikuar nga Lëvizja FOL (Mbi 10 mijë aktgjykime të publikuara nga gjykatat e Kosovës).

⁴ Artikulli i publikuar nga Kallxo.com (Gjykatat e Kosovës vazhdojnë publikimin e aktgjykimeve edhe gjatë muajit korrik 2020).

⁵ Ligji (nr. 06/L – 054) për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE – BAZA LIGJORE

Parimi i gjykimit publik, pra gjykimit me dyer të hapura, është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,⁶ ku në nenin 31 të saj parashihet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.

Për të përmbushur sa më mirë këtë mision, Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L – 054)⁷, që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparencës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshëm për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha aktgjyqimeve brenda 60 ditësh në faqet e tyre të internetit.⁸

Për dallim nga dispozitat e Ligjit aktual, Ligji për Gjykatat (nr. 03/L-199) që paraprakisht ka qenë në fuqi i obligonte gjykatat të publikojnë aktgjyqimet e plotfuqishme në faqet e tyre zyrtare të internetit, në afat kohor prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Kjo nënkupton se në raport me Ligjin e mëparshëm, Ligji aktual ka bërë progres duke e zgjeruar gamën e vendimeve gjyqësore që duhet të publikohen. Pra, përveç aktgjyqimeve të plotfuqishme, tashmë duhet të publikohen edhe ato vendime që nuk e kanë fituar ende plotfuqishmërinë ligjore.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjyqimeve Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Aktgjyqimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin e Aktgjyqimeve të Përpunuara.⁹ Ndryshe nga udhëzimi administrativ që paraprakisht ka qenë në fuqi, tashmë mbrojtësi i të akuzuarit (avokati) nuk i nënshtrohet përpunimit të të dhënave personale dhe se përjashtohet publikimi i aktgjyqimeve penale ku përfshihen personat e mitur, kontestet martesore, vërtetimi apo kundërshtimi i atësisë, etj.

Për çështjen e anonimizimit të aktgjyqimeve, sipas këtij udhëzimi, përgjegjës është bashkëpunëtori profesional apo zyrtari ligjor në secilën gjykatë dhe degë të saj, i caktuar nga kryetari i gjykatës përkatëse. Aktgjyqimet, sipas udhëzimit, duhet të publikohen në afat prej 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit. Po ashtu, nga ky udhëzim kërkohet që aktgjyqimet të vendosen në web- faqe në formatin PDF.

Për të përmirësuar cilësinë e aktgjyqimeve dhe për t'u siguruar që ato t'i përmbajnë elementet thelbësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjyqimeve dhe krijoi grupin punues për krijimin e Shabllonit për Standardizimin e Formave. Në këtë Shabllon janë paraqitur format e të gjitha aktgjyqimeve penale dhe civile dhe ndër të tjera kërkohet që në fillim të aktgjykimit të vendoset emblema e Republikës së Kosovës dhe që numri unik i lëndës të vendoset në anën e djathtë të tij, etj.

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 31.

7 Ligji (nr. 06/L – 054) për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

8 Po aty, neni 6, paragrafi 3.

9 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Publikimin e Aktgjyqimeve të Përpunuara, 2019.

PASQYRË E PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE GJATË PERIUDHËS I MAJ – 15 NËNTOR 2019

Publikimi i aktgjyqimeve në web-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka filluar që nga viti 2016, si pasojë e obligimit që vinte nga Ligji i vjetër për Gjykatat që të publikohen të gjitha aktgjyqimet e plotfuqishme. Gjatë kësaj periudhe trevjeçare (janar 2016- prill 2019), në web-faqen e KGJK-së janë publikuar 10,091 aktgjyqime, numër ky relativisht i ulët në krahasim me aktgjyqimet që publikohen aktualisht. Ndërkaq, me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Gjykatat, gjykatat janë të obliguara që të publikojnë të gjitha aktgjyqimet, pavarësisht plotfuqishmërisë së tyre ligjore.

Nga muaji maj i vitit 2019, Lëvizja FOL ka filluar monitorimin e publikimit të aktgjyqimeve në mënyrë sistematike, duke i analizuar ato në aspekt të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji dhe rregulloret në fuqi. Gjatë periudhës I maj – 15 nëntor 2019 në web-faqen e KGJK-së janë publikuar 6,611 aktgjyqime, numër ky që dëshmon rritje të theksuar të publikimit, në raport me periudhën paraprake.¹⁰

Gjykatat me më së shumti aktgjyqime të publikuara gjatë kësaj periudhe ishin: Gjykata Themelore e Ferizajt me 1,245 aktgjyqime, Gjykata e Apelit me 1,176, si dhe Gjykata Themelore e Prizrenit me 1,055 aktgjyqime.

Ndërkaq, degët e gjykatave me më së shumti aktgjyqime të publikuara ishin: dega e Kaçanikut me 215 aktgjyqime, dega e Istogut me 172 aktgjyqime, si dhe dega e Leposaviqit me 145 aktgjyqime.

Prej 6,611 aktgjyqimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe 7-mujore, 68% janë aktgjyqime penale, 28% janë aktgjyqime civile, 25% për çështje administrative, dhe vetëm 2% për çështje ekonomike. Ndërkaq sa i përket natyrës së këtyre aktgjyqimeve, 60 prej tyre janë të korrupsionit, 52 të dhunës në familje dhe 21 aktgjyqime të krimit të organizuar.

10 Raporti mbi monitorimin e publikimit të aktgjyqimeve (Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë), Lëvizja FOL, Janar 2020.


TOTALI I AKTGJYKIMEVE

I MAJ - 15 NËNTOR 2019


TABELA 2: Të dhënat me publikimet e aktgjykimeve nga secila gjykatë në periudhën maj 2019 - 15 nëntor 2019




GJYKATA SUPREME




GJYKATA E APELIT




GJYKATA THEMELORE PRISHTINË




GJYKATA THEMELORE FERIZAJ




GJYKATA THEMELORE PRIZREN




GJYKATA THEMELORE GJAKOVË




GJYKATA THEMELORE PEJË



GJYKATA THEMELORE MITROVICË



GJYKATA THEMELORE GJILAN



Publikimi i aktgjykimeve të korrupsionit ende paraqet sfidë për gjykatat tona për shkak se numri i aktgjykimeve të publikuara të kësaj natyre vazhdon të jetë ende i ulët. Gjatë periudhës paraprake (maj – nëntor 2019) si periudhë 7-mujore, ishin publikuar 60 aktgjykime të korrupsionit, numër ky që është pothuajse i njëjtë me fazën e dytë të monitorimit (62 aktgjykime të kësaj natyre). Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe është vërejtur rritja e publikimit të aktgjykimeve të dhunës me bazë gjinore (135 aktgjykime), dhe e aktgjykimeve të krimit të organizuar (50 aktgjykime). Vlen të theksohet se shumica e aktgjykimeve të këtyre natyrave janë publikuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës (22 aktgjykime të korrupsionit, 70 aktgjykime për dhunë me bazë gjinore dhe 27 aktgjykime të krimit të organizuar).

Në këtë fazë është evidentuar se disa prej degëve gjyqësore kanë filluar të publikojnë, të cilat nuk kanë pasur asnjë aktgjykim të publikuar më herët apo kanë publikuar fare pak. Duhet të theksohet se dega e Deçanit ka filluar të publikojë për herë të parë në muajin dhjetor 2019, ndërsa dega e Vushtrrisë për herë të parë ka publikuar në muajin janar 2020. Po ashtu, disa degë e kanë shumëfishuar publikimin gjatë kësaj periudhe, si p.sh. Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit, dega e Istogut, Suharekës, Kamenicës, si dhe Dega e Graçanicës.

Publikimi i aktgjykimeve nga kontestet martesore është hasur vetëm në fillim të kësaj faze të monitorimit dhe atë vetëm në 5 aktgjykime (në Gjykatën Themelore në Mitrovicë), ndërsa ky problem nuk është hasur në vazhdimësi, që dëshmon për rritjen e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

Edhe gjatë kësaj faze të monitorimit janë hasur aktgjykime të publikuara në formatin word, por gjithsesi janë reduktuar në mënyrë të theksuar në krahasim me fazën paraprake. Po ashtu, edhe në këtë fazë është hasur publikimi i aktvendimeve (për përjashtimin e publikut, heqjen dorë nga kërkesëpadi, etj.) në disa prej gjykatave, edhe pse publikimi i tyre nuk është i obliguar me ligj.

Problemi që është theksuar më shumë gjatë kësaj faze është publikimi i aktgjykimeve të periudhave të mëhershme, madje edhe të para disa viteve, që bie ndesh me obligimin që rrjedh nga Ligji i ri për Gjykatat, që aktgjykimet të publikohen 60 ditë pas nxjerrjes së tyre. Publikimi i aktgjykimeve të vjetra është vërejtur në veçanti në Gjykatën Themelore të Prizrenit.



GJYKATA SUPREME

Gjykata Supreme, duke përfshirë Kolegjin e Apelit dhe Dhomën e Posaçme, gjatë kësaj periudhe të monitorimit (nëntor 2019 – gusht 2020) ka publikuar gjithsej **1,052 aktgjykime**, numër ky që dëshmon një rritje të theksuar të publikimit, në krahasim me aktgjykimet e publikuara në periudhën maj – 15 nëntor 2019 (**415 aktgjykime**). Më së shumti aktgjykime kjo Gjykatë ka publikuar në muajin qershor, respektivisht **277 aktgjykime**.

Në figurën e mëposhtme është pasqyruar publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës nëntor 2019 – gusht 2020.




FIGURA 1. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Supreme

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme gjatë kësaj periudhe ka publikuar 339 aktgjykime, ndërsa Kolegji i Apelit ka publikuar 198 aktgjykime. Publikimi i aktgjykimeve nga Dhoma e Posaçme dhe Kolegji i Apelit për çdo muaj, në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 2: Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Supreme

Më shumë se gjysma e aktgjykimeve të publikuara nga kjo Gjykatë janë të natyrës civile, respektivisht 729 aktgjykime civile, 215 aktgjykime janë të natyrës penale, ndërsa 108 prej tyre janë të natyrës administrative. Ndërsa vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe nuk është publikuar asnjë aktgjykim për çështje ekonomike.

Në tabelën në vijim është paraqitur ndarja e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Supreme, sipas natyrës së lëndëve.




TABELA 4: Ndarja e aktgjykimeve të publikuara sipas natyrës

Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, Gjykata Supreme në periudhën e monitorimit ka publikuar vetëm 1 aktgjykim të natyrës së korrupsionit dhe 2 aktgjykime të dhunës me bazë gjinore. Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar, 106 aktgjykime janë të publikuara në gjuhën serbe, ndërsa pjesa tjetër prej 946 aktgjykimesh janë publikuar në gjuhën shqipe.

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo Gjykatë nuk është zbatuar në nivelin e duhur. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, vetëm në 184 aktgjykime është zbatuar ky vendim, ndërsa në pjesën tjetër prej 869 aktgjykimesh nuk është zbatuar.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike zbatimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga ana e gjykatësve të Gjykatës Supreme.




FIGURA 3: Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Aktgjykimeve nga Gjykata Supreme

Ndërkaq, Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara është zbatuar në të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo Gjykatë. Ndryshe nga periudha e kaluar e monitorimit (maj-nëntor 2019), ku kemi hasur në 17 aktgjykime të paanonimizuar, tashmë asnjë aktgjykim i kësaj Gjykate nuk është publikuar i paanonimizuar.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 58 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë aktgjykimet i publikon në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Gjykatat, ku kërkohet që aktgjykimet të publikohen në afatin prej 60 ditësh për publikimin e tyre, llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimeve.

Lëvizja FOL gjithashtu ka monitoruar se cilët gjyqtarë kanë publikuar më shumë aktgjykime gjatë kësaj periudhe. Nga ky monitorim kemi listuar nga 5 gjyqtarë të secilës gjykatë që kanë prirë në publikim. Në figurën e mëposhtme është paraqitur lista prej 5 gjyqtarëve që kanë publikuar më shumë aktgjykime në Gjykatën Supreme.



FIGURA 4: Pasqyra e gjyqtarëve me së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Supreme



GJYKATA E APELIT

Gjykata e Apelit, duke përfshirë Divizionin e Apelit të Mitrovicës, gjatë periudhës nëntor 2019- gusht 2020 ka publikuar gjithsej **1,631 aktgjykime**, duke u radhitur kështu në vendin e tretë sa i përket numrit të aktgjykimeve të publikuara. Në krahasim me periudhën paraprake, ky publikim është rritur për **38.70%**. Më së shumti aktgjykime kjo Gjykatë ka publikuar në muajin qershor, respektivisht **242 aktgjykime**.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur niveli i publikimit të aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit në periudhën nëntor 2019 – gusht 2020.




FIGURA 5. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën e Apelit

Publikimi i aktgjykimeve në Divizionin e Apelit të Mitrovicës vazhdon të jetë i paktë në numër edhe në fazën e dytë të monitorimit. Gjatë kësaj periudhe ajo ka publikuar vetëm 6 aktgjykime, duke e rritur në 16 numrin e aktgjykimeve të publikuara në total.

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar publikimi i aktgjykimeve nga Divizioni i Apelit të Mitrovicës, në baza mujore.

Divizioni i Apelit të Mitrovicës
Nëntor 2019 - gusht 2020




FIGURA 6. Publikimi i aktgjykimeve nga dega e Gjykatës së Apelit

Sa i përket natyrës së lëndëve, edhe Gjykata e Apelit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, 1,146 prej tyre janë të natyrës civile, 320 sosh të natyrës penale, 132 të natyrës administrative, ndërsa vetëm 33 aktgjykime të çështjeve ekonomike.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet publikimi i aktgjykimeve të kësaj gjykate, të ndarë sipas natyrës së lëndëve.

Natyra e lëndëve	Penale	Civile	Administrative	Ekonomike
Gjykata e Apelit	320	1,146	33	132
TOTAL 1,631 AKTGJYKIME				

TABELA 5: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së tyre

Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar vetëm 4 aktgjykime të rasteve të korrupsionit dhe 3 aktgjykime nga lëndët e krimit të organizuar. Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar, Gjykata e Apelit ka publikuar 1,589 aktgjykime në gjuhën shqipe, ndërsa vetëm 42 sosh në gjuhën serbe.

Zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo Gjykatë ka arritur progres të theksuar në raport me fazën e kaluar të monitorimit. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, në 472 aktgjykime nuk është zbatuar ky vendim në mënyrën e

përcaktuar. Ndërsa në pjesën tjetër prej 1,159 aktgjykimesh, vendimi është zbatuar në përpikëri. Ndryshe nga kjo, gjatë fazës së parë të monitorimit asnjë aktgjykim i Gjykatës së Apelit nuk është publikuar me emblemën e Republikës së Kosovës, por vetëm me atë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Në figurën në vijim është paraqitur zbatimi i këtij udhëzimi.




FIGURA 7. Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit

Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara është zbatuar në mënyrë të plotë nga të gjitha aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të publikuara gjatë kësaj periudhe. Nga numri total i aktgjykimeve të publikuara, respektivisht nga 1,481 aktgjykime, asnjë prej tyre nuk është publikuar pa u anonimizuar. Kjo dëshmon ngritjen e përgjegjësisë dhe përkushtimin e madh të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë të kësaj Gjykate, të cilët merren me publikimin e aktgjykimeve.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 52 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se edhe kjo Gjykatë aktgjykimet i publikon në pajtim me kohën e paraparë për publikimin e tyre në Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.



FIGURA 8. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën e Apelit



GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 4 degët e saj (dega në Podujevë, dega në Graçanicë, dega në Lipjan dhe dega në Glllogoc), është gjykata me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë periudhës nëntor 2019 – gusht 2020. Gjatë kësaj kohe, kjo Gjykatë ka publikuar **4,000 aktgjykime**, numër ky që është katërfishuar në krahasim me periudhën paraprake të monitorimit (**676 aktgjykime** gjatë periudhës maj-nëntor 2019). Pra, të dhënat tregojnë për vetëdijësimin e Gjykatës lidhur me rëndësinë e publikimit të aktgjykimeve, kur e bëjmë dallimin në mes të dy periudhave të monitorimit.

Dihet se Gjykata Themelore në Prishtinë përbëhet edhe nga tri departamente shtesë (Departamenti Special, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike), të cilat kanë kompetencë territoriale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, prandaj është i kuptueshëm fluksi i madh i lëndëve të kësaj Gjykate, në krahasim me gjykatat e tjera.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e aktgjykimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës nëntor 2019 – gusht 2020.




FIGURA 9. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës

Në këtë numër të madh të publikimit në masë të madhe kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. Dega e Podujevës që vepron në kuadër të kësaj Gjykate, gjatë kësaj periudhe ka publikuar 477 aktgjykime, dega e Lipjanit 391 aktgjykime, dega e Glllogocit 282 aktgjykime dhe dega e Graçanicës ka publikuar 55 aktgjykime. Shifrat e publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë në mënyrë grafike janë paraqitur edhe në tabelë në vijim.




FIGURA 10. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore Prishtinë

Ndërkaq, sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, ndryshe nga Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit, kjo Gjykatë prinë me publikimin e aktgjykimeve të natyrës penale. Respektivisht, nga numri i përgjithshëm i publikimit, 2,317 aktgjykime janë të natyrës penale, 919 të natyrës civile, 654 prej tyre administrative dhe 110 aktgjykime për çështje ekonomike. Ndarja e tillë e aktgjykimeve duke u bazuar në natyrën e tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.




TABELA 6: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së veprës

Nga aktgjykimet penale, 22 aktgjykime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, 70 aktgjykime për dhunë me bazë gjinore dhe 27 aktgjykime të krimit të organizuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar vetëm 27 aktgjykime në gjuhën serbe, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimeve janë publikuar në gjuhën shqipe.

Shablloni i Publikimit të Aktgjykimeve është zbatuar në masë të konsiderueshme nga kjo Gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i publikimit, ky Shabllon është aplikuar në 3,760 aktgjykime, ndërsa në 240 aktgjykimet e tjera janë vërejtur lëshime në zbatimin e tij. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike aplikimi i Shabllonit për Publikim të Aktgjykimeve nga gjyqtarët e kësaj Gjykate.




FIGURA 11. Përdorimi i Shabllonit për Publikimin e Aktgjykimeve nga Gjykata Themelore në Prishtinë

Ndërkaq, sa i përket fshehjes së të dhënave personale në aktgjykimet e publikuara duhet të theksohet se kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të publikuara, vetëm 26 prej tyre apo 0,7% aktgjykime kanë qenë të paanonimizuara.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 63 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë e tejkalon lehtësisht kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti aktgjykime në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë paraqitur në grafikonin në vijim.



FIGURA 12. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës



GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë degën e Suharekës dhe atë të Dragashit, është vlerësuar si Gjykata e dytë me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Gjatë kësaj periudhe, kjo Gjykatë ka publikuar gjithsej **2,793 aktgjykime**, apo më shumë se dy herë më shumë aktgjykime sesa në fazën e parë të monitorimit (**1,054 aktgjykime**).

Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të aktgjykimeve nga kjo Gjykatë, për secilin muaj.




FIGURA 13. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Kontribut të madh në rritjen e publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj Gjykate kanë pasur edhe degët e saj. Duhet të theksohet se dega e Suharekës është dega me më së shumti aktgjykime të publikuara, respektivisht me 987 aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Ndërsa dega e Dragashit në web-faqe ka publikuar gjithsej 206 aktgjykime. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 14. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit

Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, kjo Gjykatë prin me publikimin e aktgjykimeve penale, me 2,074 sosh, ndërsa ka publikuar dyfish më pak aktgjykime civile. Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.




TABELA 7: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së veprës

Nga aktgjykimet penale, vetëm 2 prej tyre kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsionit, 16 të dhunës me bazë gjinore dhe 2 aktgjykime për lëndët e krimit të organizuar.

Nga 2,793 aktgjykime të publikuar në web-portalin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, vetëm 2 aktgjykime kanë qenë të publikuara në gjuhën serbe.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale edhe kjo Gjykatë ka treguar kujdes të shtuar. Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo Gjykatë, vetëm 1 aktgjykim është evidentuar i paanonimizuar.

Edhe Shablloni për Publikimin e Aktgjytimeve është aplikuar në masë të konsiderueshme, madje ka pasur rezultat pozitiv në krahasim me fazën e parë të monitorimit. Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo Gjykatë, lëshime në publikimin e Shabllonit janë vërejtur në 274 aktgjytime. Ndërkaq, në pjesën tjetër prej 2,519 aktgjykimesh, Shablloni është aplikuar në përpikëri.

Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Shabllonit për Publikim të Aktgjytimeve nga gjyqtarët e kësaj Gjykate, për çdo muaj.




FIGURA 15. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit

Nga monitorimi i publikimit të aktgjytimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 409 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë e kalon në mënyrë të theksuar kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjytimeve. Gjatë kësaj periudhe, kjo Gjykatë ka publikuar edhe aktgjytime të viteve të kaluara, madje edhe të viteve 2013-2017.

Pesë gjyqtarët të cilët kanë publikuar më së shumti aktgjytime në këtë Gjykatë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.



FIGURA 16. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjytime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit



GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpcës, gjatë periudhës nëntor 2019 - gusht 2020 ka publikuar **1,614 aktgjytime**. Gjatë fazës së parë të monitorimit kjo Gjykatë është renditur e para sa i përket publikimit të aktgjytimeve (**me 1,245 aktgjytime**). Në fazën e dytë të monitorimit, Gjykata e Ferizajt renditet e katërta për nga numri i publikimit. Kjo Gjykatë ka publikuar aktgjytime brenda afatit ligjor për publikim, e që është tregues i qartë për rritjen e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjytimeve të Përpunuara, mirëpo në anën tjetër ka ndikuar në uljen e publikimit të aktgjytimeve në këtë Gjykatë sepse nuk janë publikuar aktgjytime të vjetra.

Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike publikimi i aktgjytimeve nga kjo Gjykatë, përgjatë muajve monitorues.




FIGURA 17. Statistikat e përgjithshme të aktgjytimeve në Gjykatën Themelore të Ferizajt

Edhe degët e kësaj Gjykate kanë publikuar numër relativisht të madh të aktgjyimeve. Dega e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe ka publikuar 272 aktgjyime, ndërsa dega e Shtërpcës ka publikuar 33 aktgjyime.

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Ferizaj, për çdo muaj.




FIGURA 18. Publikimi i aktgjyimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt

Gjykata Themelore e Ferizajt, sikurse Gjykata Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar dukshëm më shumë aktgjyime të natyrës penale, sesa civile. Nga numri i përgjithshëm i aktgjyimeve, 1,117 aktgjyime janë të natyrës penale, ndërsa 497 të natyrës civile.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur ndarja e aktgjyimeve të publikuara sipas natyrës së tyre.



TABELA 8: Ndarja e aktgjyimeve sipas natyrës së veprës

Nga të gjitha aktgjyimet penale të publikuara nga kjo Gjykatë, vetëm 2 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit, 16 aktgjyime të dhunës me bazë gjinore dhe vetëm 4 aktgjyime të krimit të organizuar.

Sa i përket gjuhës së publikimit të aktgjyimeve, kjo Gjykatë gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar 27 aktgjyime në gjuhën serbe ndërsa 1,587 sosh në gjuhën shqipe.

Gjykata Themelore e Ferizajt bashkë me degët e saj është ndër gjykatat që më së shumti e ka zbatuar vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sa i përket përdorimit të Shabllonit për Publikimin e Aktgjyimeve. Gjatë kësaj periudhe, Shablloni është zbatuar në 1,571 aktgjyime apo në 97% nga totali i përgjithshëm, ndërsa në pjesën tjetër prej 43 aktgjyimeve, janë vërejtur lëshime nga përdorimi i tij.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet zbatimi i këtij Shablloni në tërësi.




FIGURA 19. Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Aktgjyimeve

Në mënyrë të njëjtë si në fazën e parë të monitorimit, Gjykata Themelore e Ferizajt ka treguar kujdes të veçantë në anonimizimin apo fshehjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjyimeve. Nga numri i përgjithshëm i aktgjyimeve të publikuara, vetëm 2 aktgjyime janë evidentuar të paanonimizuara.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjyimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 54 ditë për t'i publikuar aktgjyimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë aktgjyimet i publikon në pajtim me kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjyime të publikuara gjatë periudhës së monitorimit nga Gjykata Themelore në Ferizaj.



FIGURA 20. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti publikime në Gjykatën Themelore të Ferizajt



GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (Skenderajn, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun) gjatë periudhës nëntor 2019 – gusht 2020 në web-faqe ka publikuar gjithsej **1,581 aktgjykime**. Në krahasim me periudhën paraprake të monitorimit, publikimi i aktgjykimeve nga kjo Gjykatë gjatë kësaj periudhe është rritur për **121%**.

Publikimi i aktgjykimeve nga kjo Gjykatë për secilin muaj, në mënyrë grafike është shfaqur në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 21. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës

Duhet të theksohet se disa prej degëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim për disa muaj me radhë, gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Fjala është për degën në Zubin Potok dhe atë në Leposaviq, të cilat për pesë muaj nuk kanë publikuar asnjë aktgjykim. Në anën tjetër, dega në Vushtrri nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në fazën e parë të monitorimit, ndërsa gjatë kësaj faze ka publikuar 203 aktgjykime, ndërsa dega në Skenderaj kishte publikuar 144 aktgjykime. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafikisht në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 22. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara janë të natyrës penale, përkatësisht 1,001 aktgjykime penale, ndërsa 580 aktgjykime janë të natyrës civile.




TABELA 9: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së tyre

Nga aktgjykimet penale, kjo Gjykatë gjatë kësaj periudhe ka publikuar vetëm 2 aktgjykime të korrupsionit, 3 me bazë në dhunë gjinore si dhe 2 të krimit të organizuar.

Për dallim nga gjykatat e tjera, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë publikimi i aktgjykimeve në gjuhën serbe është më i madh në numër se ai në gjuhën shqipe. Nga 1,581 aktgjykime të publikuara në tërësi, 803 janë në gjuhën serbe, ndërsa 778 sosh në gjuhën shqipe.

Sa i përket fshehjes së të dhënave personale, kjo Gjykatë ka publikuar 26 aktgjykime të paanonimizuara, ndryshe nga faza e parë e monitorimit ku nuk kemi hasur në asnjë aktgjykim të paanonimizuar.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve, nga të gjitha aktgjykimet e publikuara nga kjo Gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 686 aktgjykime. Ndërsa në pjesën tjetër prej 895 aktgjykimesh, ky vendim është zbatuar me korrektësi.

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është shfaqur shkalla e zbatimit të këtij vendimi nga kjo Gjykatë për secilin muaj.




FIGURA 23. Përdorimi i Shabllonit në publikimin e aktgjykimeve

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 53 ditë për t'i publikuar aktgjykimet.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pesë gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe në këtë Gjykatë.



FIGURA 24. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Mitrovicës



GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë degën e Rahovecit dhe atë të Malishevës, gjatë kësaj periudhe në web-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej **1,352 aktgjykime**, apo **63%** më shumë aktgjykime se në fazën e parë të monitorimit. Me këta numra statistikore, shihet qartë se ka një avancim të ndjeshëm të publikimeve nga kjo Gjykatë përkundër faktit se ajo renditet e gjashta në renditjen e gjykatave me më së shumti publikime të aktgjykimeve në web-faqet e tyre.

Publikimi i aktgjykimeve për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 25. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Gjakovës

Edhe degët e kësaj Gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të aktgjykimeve në kuadër të kësaj Gjykate. Dega e Malishevës ka publikuar 247 aktgjykime, ndërsa dega e Rahovecit 364 aktgjykime. Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i këtyre degëve, për çdo muaj.




FIGURA 26. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës

Sa i përket natyrës së aktgjykimeve të publikuara, numër shumëfish më i madh i tyre është i natyrës penale apo 1,124 aktgjykime të kësaj natyre. Ndërsa gjatë kësaj periudhe kjo Gjykatë ka publikuar 228 aktgjykime të natyrës civile.




TABELA 10: Ndarja e aktgjykimeve sipas llojit të lëndëve

Gjatë kësaj periudhe, kjo Gjykatë ka publikuar 15 aktgjykime të korrupsionit, 12 aktgjykime me bazë në dhunë gjinore dhe 3 aktgjykime të krimit të organizuar.

Në Gjykatën Themelore në Gjakovë të gjitha aktgjykimet janë publikuar në gjuhën shqipe.

Sa i përket anonimizimit të aktgjykimeve janë evidentuar vetëm 2 aktgjykime të paanonimizuara. Sikurse edhe në fazën e parë të monitorimit, kjo shpërfaq përkushtimin e zyrtarëve të kësaj Gjykate që merren me publikimin e aktgjykimeve.

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjakovës është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 69 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë e kalon ndjeshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në shumicën e aktgjykimeve të publikuara nga kjo Gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë evidentuar vetëm në 43 aktgjykime të publikuara. Zbatimi i këtij vendimi nga kjo Gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 27. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykimet e publikuara

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.



FIGURA 28. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës



GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (degën e Kamenicës, Vitisë e Novobërdës), është ndër gjykatat me më së paku aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Kjo Gjykatë ka publikuar gjithsej **854 aktgjykime**, numër ky që është shumëfishuar në raport me fazën e parë të monitorimit. Duhet të përmendet se në fazën e parë kjo Gjykatë ishte renditur si gjykata me më së paku aktgjykime të publikuara, ndërsa tash mbrapa saj qëndron Gjykata Themelore e Pejës.

Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga kjo Gjykatë për secilin muaj është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 29. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Gjilanit

Degët e kësaj Gjykate kanë filluar të aktivizohen sa i përket publikimit të aktgjykimeve në këtë periudhë të monitorimit. Dega e Vitisë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 31 aktgjykime, dega e Kamenicës 64 aktgjykime, ndërsa dega e Novobërdës ka publikuar 38 aktgjykime. Niveli i publikimit të aktgjykimeve nga degët e kësaj Gjykate, për çdo muaj, është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 30. Publikimi i aktgjykimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjilanit

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara nga kjo Gjykatë janë të natyrës penale. Në tabelën e mëposhtme është përshkruar klasifikimi i aktgjykimeve sipas natyrës.




TABELA 11: Ndarja e aktgjykimeve sipas natyrës së tyre

Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në web-portal, ne kemi evidentuar 13 aktgjykime për korrupsionin, 8 aktgjykime me bazë në dhunë gjinore si dhe 9 për krim të organizuar.

Gjykata Themelore e Gjilanit në gjuhën shqipe ka publikuar 719 aktgjykime ndërsa 37 në gjuhën serbe.

Kujdes i theksuar është treguar në fshehjen e të dhënave personale gjatë publikimit të aktgjykimeve nga kjo Gjykatë. Gjatë monitorimit nuk kemi evidentuar asnjë aktgjykim të paanonimizuar.

Edhe zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve nga kjo Gjykatë është arritur në

nivel të kënaqshëm. Gjatë monitorimit ne kemi evidentuar vetëm 59 aktgjykime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e këtij Vendimi. Kjo në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 31. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykimet e publikuara

Nga monitorimi i publikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërejtur se kësaj Gjykate i janë dashur mesatarisht 143 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë e kalon në mënyrë të theksuar kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjykimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga kjo Gjykatë.



FIGURA 32. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjykime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit



GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (Deçanin, Istogun dhe Klinën), është Gjykata me më së paku aktgjykime të publikuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Kjo Gjykatë ka publikuar gjithsej **840 aktgjykime** apo **40%** më shumë aktgjykime se në fazën e parë të monitorimit, mirëpo përkundër rritjes së numrit të aktgjykimeve të publikuara, kjo Gjykatë renditet e fundit në publikimin e tyre.

Publikimi i aktgjykimeve nga kjo Gjykatë është pasqyruar në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.




FIGURA 33. Statistikat e përgjithshme të aktgjykimeve në Gjykatën Themelore të Pejës

Ajo që është e rëndësishme të përmendet për këtë fazë të monitorimit është se dega e Deçanit, që funksionon në kuadër të kësaj Gjykate, për herë të parë ka filluar të publikojë në muajin shkurt të këtij viti. Ndërsa e njëjta nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në fazën e parë të monitorimit. Në grafikonin e mëposhtëm është pasqyruar niveli i publikimit të aktgjyqimeve nga degët e kësaj Gjykate për çdo muaj.




FIGURA 34. Publikimi i aktgjyqimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës

Nga numri i përgjithshëm i aktgjyqimeve të publikuara, 620 aktgjyqime janë të natyrës penale, ndërsa 220 sosh janë të natyrës civile. Ndarja e tillë e aktgjyqimeve të publikuara është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.




TABELA 12: Ndarja e aktgjyqimeve sipas natyrës së veprës

Nga të gjitha aktgjykimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 2 aktgjyqime të korrupsionit dhe 11 aktgjyqime të dhunës me bazë gjinore.

Gjykata Themelore e Pejës gjatë kësaj periudhe nuk kishte të publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe.

Sa i përket fshehjes së të dhënave personale, edhe kjo Gjykatë ka treguar kujdes të shtuar. Ne gjatë monitorimit kemi evidentuar vetëm 8 aktgjyqime të paanonimizuara.

Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjyqimeve është arritur në shumicën e aktgjyqimeve të publikuara nga kjo Gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 158 aktgjyqime të publikuara. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga kjo Gjykatë për çdo muaj.




FIGURA 35. Përdorimi i Shabllonit në aktgjykimet e publikuara

Nga monitorimi i publikimit të aktgjyqimeve të Gjykatës Themelore të Pejës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 68 ditë për t'i publikuar aktgjykimet. Kjo nënkupton se kjo Gjykatë e kalon ndjeshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e aktgjyqimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar gjyqtarët me më së shumti aktgjyqime të publikuara në këtë Gjykatë.



FIGURA 36. Pasqyra e gjyqtarëve me më së shumti aktgjyqime të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës

REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e këtij raporti të monitorimit, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve në këtë fushë:

- 1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të monitorojë gjykatat mbi nivelin e zbatimit të të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke përfshirë edhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjyqimeve. Në të njëjtën kohë, KGJK duhet të kërkojë nga kryetarët e gjykatave që të raportojnë mbi arsyet e moszbatimit të rregulloreve dhe vendimeve në fjalë;
- 2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të rrisë numrin e zyrtarëve për informim, në veçanti në gjykatat me fluks më të madh të lëndëve, si për shembull në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe atë të Prizrenit;
- 3 Të caktohet zyrtari për informim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës sepse kjo Gjykatë vazhdon të mos ketë ende zyrtar për informim;
- 4 Të bëhet kyçja në internet e degës së Zubin Potokut në Mitrovicë;
- 5 Të përditësohet web-portali i KGJK-së me lajme ditore dhe me njoftime të rëndësishme për publikun. Gjatë periudhës së monitorimit, Lëvizja FOL ka vërejtur se shpesh web-portali nuk është përditësuar me lajme të reja, duke përfshirë këtu raportet statistikore, të cilat duhet të publikohen në web në baza mujore. Po ashtu, vlen të theksohet që duhet të bëhet përditësimi i gjyqtarëve aktivë në gjykata (në shumë gjykata figurojnë gjyqtarët e pensionuar, gjyqtarët që kanë ndërruar gjykatë apo edhe ata që kanë vdekur);
- 6 Degët të pavarësohen nga gjykatat themelore në aspektin e publikimit të aktgjyqimeve;
- 7 Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjyqimeve duhet të jetë prioritet;
- 8 Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga zyrtarët për informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimit me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjyqimeve të Plotfuqishme. Siç e kemi theksuar më lartë, vazhdon një numër i konsiderueshëm i aktgjyqimeve të publikohen të paanonimizuara. Andaj ne rekomandojmë që zyrtarët përkatës të rishikojnë aktgjykimin para publikimit;
- 9 Të rritet publikimi i aktgjyqimeve të korrupsionit;
- 10 Aktgjykimet të publikohen me kohë në web-faqen e KGJK-së, e jo të publikohen tërësisht në ditën e fundit të muajit dhe të respektohet afati i paraparë në Ligjin për Gjykatat në lidhje me publikimin e tyre, si dhe
- 11 Të shënohen në të gjitha aktgjykimet parashtesat e numrave arkivorë që kanë për qëllim të tregojnë se për çfarë lënde bëhet fjalë (p.sh rast penal, civil etj.).

BURIMET

- 1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill 2008.
- 2 Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tetor 2013.
- 3 Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat. Dhjetor 2018.
- 4 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjyqimeve të Plotfuqishme. Shkurt 2016.
- 5 Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Shabllonet Standarde të Aktgjyqimeve – Vëllimi I. 2018.

